



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/485
Datë: 23 / 8 / 2024

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", shpallë:

KONKURS
për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor për vitin akademik
2024/2025

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 106 të Statutit, në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2024, ka miratuar propozimet e njësisve akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2024/25 dhe ka miratuar kriteret për regjistrim në studimet themelore - baçelor. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga Senati, gjithashtu janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në tekstin e mëtejme MASHTI) me shkresën nr. prot. 01/B 1855, datë 02.07.2024.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2024/2025, do të regjistrojë **597** studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI, universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht deri në **69** studentë të rregullt nga komuniteti jo shumicë. Kuota prej **12%** e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Në universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve, mund të pranohen deri në **2%**, përkatësisht deri në **12** kandidatë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, deri në **2%**, përkatësisht deri në **13** kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Republika e Shqipërisë dhe deri në **1%**, përkatësisht deri në **4** kandidatë nga Mali i Zi. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërhënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
4. Përjashtimisht kushteve të veçanta, të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2 dhe 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. Universiteti i Prishtinës, mbi bazën e konsideratave humane, kandidatëve me nevoja të veçanta, me rastin e aplikimit do t'ua shtoj nga 5 pikë bonus. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohet me certifikata përkatëse, të lëshuara nga institucionet gjegjëse.
6. Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
7. Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.

8. Në universitet mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
9. Kandidatë jo kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe që nuk kanë nënshtetësi Kosovare.
10. Dëshmia për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës merret në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ndërsa barasvlera e notave do të bëhet nga Zyra për Zhvillim Akademik, e cila gjendet në Fakultetin Filozofik, kati II, nr. 107.
11. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën, në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram, përveç në rastet specifike, ku testi do të përgatitet në gjuhën, në të cilën zhvillohet programi.
12. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik, duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
13. **Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, konsiderohet vepër penale. Kandidati/ja që mbi bazën e deklaramit të rrejshëm, apo dokumentacionit të falsifikuar ka arritur të pranohet në mënyrë të padrejtë në Universitetin e Prishtinës, do të përjashtohet në mënyrë automatike nga Universiteti I Prishtinës, në momentin e vërtetimit të një fakti të tillë.**
14. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UP pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
15. **Kandidatët për pranim si studentë të UP-së në vitin akademik 2024/25 nuk mund të konkurrojnë në më shumë se një fakultet, departament, drejtim apo program.**

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:
 - a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë dhe
 - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
 - b) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
 - Suksesi në maturë deri në 30 pikë dhe
 - Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues, deri në numrin e paraparë sipas konkursit.
3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
4. Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafët 2 dhe 3 të pikës

I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.

5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
6. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
7. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve që kanë konkurruar t'ia dërgojnë rektoratit të universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e fakultetit.
8. Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës, drejtimit ose programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 10 studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.
9. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtij prioriteti:
 - a) Kandidati/ja i/ cili/a ka rezultat më të mirë të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta;
 - b) Kandidati/ja i/ cili/a ka sukses më të mirë të shkollës së mesme, e nëse edhe pikët e provimit pranues dhe të suksesit të shkollës së mesme janë të njëjta;
 - c) Kandidati/ja i/ cili/a ka rezultat më të mirë nga testi i maturës.
 - d) Në qoftë se edhe sukcesi është i njëjtë, atëherë përzgjedhja e kandidatit/es fitues, do të bëhet përmes tërheqjes së shorti në prani të kandidatëve me pikë të barabarta si në paragrafët a), b) dhe c) të pikës 9.

III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online <http://apliko.uni-pr.edu> do të jetë i hapur prej datës **23.8.2024** deri më datë **5.9.2024** në orën 16.00.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **23.8.2024**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **13:00**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **23.8.2024** deri më datë **5.9.2024**. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula e noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim fizik është si në vijim:**
 - a) *Ekstrakti i lindjes (origjinal) jo më i vjetër se 6 muaj;*
 - b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinale, dublikatë ose të noterizuara);*
 - c) *Diploma e kryerjes së shkollës së mesme (origjinale, dublikatë ose e noterizuar);*
 - d) *Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinale, dublikatë ose e noterizuar);*
 - e) *Kopjen e letërnjoftimit;*
 - f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>;*
 - g) *Dëshmia mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. Lista e institucioneve parauniversitare të licencuara në vend, sigurohet në MASHTI nga Administrata Qendrore e UP-së (nëse kandidatët nuk mund ta sigurojnë këtë dëshmi gjatë periudhës së aplikimit online, atëherë dëshmia mund të dorëzohet me rastin e aplikimit fizik).*
6. **Me rastin e aplikimit në datat e caktuara si në pikën 3 të kapitullit III, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e kërkuara si në pikën 5 të këtij kapitulli, t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve në dosje (fashikull) të bardhë, e cila duhet të jetë unike për të gjithë kandidatët.**

7. Nëse gjatë aplikimit online, kandidati gabimisht aplikon në një program tjetër studimor, atëherë duhet të kërkojë nga zyrtari i TI-së i fakultetit përkatës t'i fshihet aplikimi i gabuar nga sistemi në mënyrë që t'i mundësohet procedura e aplikimit nga fillimi. Kjo procedurë duhet të përfundojë para datës së mbylljes të aplikimit online.
8. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë për aplikim fizik, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati, pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.
9. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në uebfaqet e këtyre fakulteteve.
10. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të paraqitura si më poshtë:
 1. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, me datë **9.9.2024**, fillon në orën **9:00**;
 2. Fakulteti i Arteve, me datë **9.9.2024, 10.9.2024 dhe 11.9.2024**, duke filluar nga ora **9:00**;
 3. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, me datë **9.9.2024**, duke filluar nga ora **9:00**;
11. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të kenë me vete letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
12. **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE

1. **Shpallja e rezultateve preliminare** e provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse sipas grupeve të fakulteteve, bazuar në datat e mbajtjes së provimit pranues dhe atë:
 - a) Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Arteve dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë më së voni deri më datë **11.9.2024**, në orën **16:00**;
 - b) Fakulteti i Arteve më së voni deri më datë **12.9.2024**, në orën **16:00**.
2. *Rezultati preliminar nuk është rezultat përfundimtar. Me rastin e shpalljes së rezultatit preliminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, pasi me rastin e miratimit si të bazuar të ankesës, dikush nga kandidatët mund të radhitet me lart me pikë se kandidati i radhitur sipas rezultatit preliminar.*

V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preliminar renditen si kandidatë të papranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare** (llogaritet edhe dita e shtunë), respektivisht për grupet si në vijim:
 - a) Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë më së voni **13.9.2024**, në ora **16:00**;
 - b) Fakulteti i Arteve më së voni **16.9.2024**, në ora **16:00**.
3. Pas afatit të përcaktuar si pikën e sipërshtuar ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet, menjëherë pas mbylljes së afati ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës.
 1. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **16.9.2024-18.9.2024 (3 ditë pune)**.
 2. Kandidatët të cilët kanë kaluar pragun e kalueshmërisë të përcaktuar si në Pjesën II (Mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve), paragrafi 3 dhe 4 të këtij konkursi, mirëpo për arsye se janë plotësuar të

gjitha vendet e parapara në programin në të cilin kanë aplikuar, të njëjtit kanë ngelë jashtë listave të kandidatëve të pranuar, atëherë bazuar në ranglistën sipas pikëve të grumbulluara, të njëjtit mund të pranohen në programet studimore brenda njësisë akademike, në të cilat kanë mbetur vende të lira, me kusht që të kenë pasur testet e njëjta të provimit pranues.

3. Pranimi i kandidatëve si paragrafin 3 të kësaj pike do të bëhet vetëm pas shprehjes së interesimit për pranim në programin përkatës.
4. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, do të shpallë konkurs plotësues:
 - 5.1. Për ato programe, në të cilat nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, as pas zbatimit të paragrafit 3 të pikës V;
 - 5.2. Për ato programe, në të cilat nuk janë plotësuar të gjitha vendet në kuadër të kuotës së rezervuar.
6. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t’u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-pr.edu.

VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. **Shpallja e rezultateve përfundimtare** të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse, pas shqyrtimit të ankesave sipas grupeve të fakulteteve, bazuar në datat e mbajtjes së provimit pranues dhe atë:
 - a) më së voni deri më datë **14.9.2024**, pas orës **16:00**;
 - b) më së voni deri më datë **17.9.2024**, pas orës **16:00**;

VII. AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT E PRANUAR

1. **Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në Administratën Qendrore të UP-së (ndërtesa e Bibliotekës Universitare), sipas këtij orari:**
 - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, datë **17.9.2024**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, datë **19.9.2024**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**.
 - Fakulteti i Arteve, datë **19.9.2024**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**.
2. **Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më **5.10.2024**, në orën **15:00**. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen për shkak të mbylljes së Sistemit për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), prandaj luten që t’i përmbahen afatit të lartshënuar.**
3. Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar, nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.
4. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 - a) Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili shkarkohet dhe shtypet (bardh e zi) nga faqja <http://apliko.uni-pr.edu>
 - b) Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
 - c) Sipas UA (MASHTI) Nr. 09/2021, të gjithë studentët që fillojnë studimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” lirohen nga pagesa e tarifës së shkollimit lirohen nga pagesa e tarifës së shkollimit kur e regjistrojnë semestrin për herë të parë.

VI. FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **160** studentë të rregullt dhe atë sipas departamenteve si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitet et jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsëj
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	134	19	3	3	1	160
Departamenti i Konstruksioneve	101	14	2	2	1	120
Programi Konstruktiv	101	14	2	2	1	120
Departamenti i Hidroteknikës	33	5	1	1	0	40
Programi Hidroteknikë	33	5	1	1	0	40

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë.

Për t'u pranuar, kandidati duhet të arrijë minimum 40% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues, përveç kandidatëve që i takojnë kategorisë së kandidatëve të cilët aplikojnë në kuadër të kuotave të veçanta, të cilët duhet të arrijnë minimum 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

X. FAKULTETI I ARTEVE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **187** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Kandidatë nga komunitet et jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsëj
Arteve të Bukura	160	20	3	4	0	187
<i>Departamenti i Arteve të Bukura</i>	44	5	1	0	0	50
<i>Programi Bachelor i Arteve Vizuele</i>	44	5	1	0	0	50
Profili Pikturë	10	1	1	0	0	12
Profili Skulpturë	5	0	0	0	0	5
Profili Grafikë	7	1	0	0	0	8
Profili Arti konceptual dhe	5	0	0	0	0	5

mediet e reja						
Profili Dizajn i inovacioneve	6	1	0	0	0	7
Profili Dizajn i komunikimit	7	1	0	0	0	8
Profili Ilustrim dhe vizatim	4	1	0	0	0	5
Departamenti i Artit Muzikor	66	9	1	1	0	77
Programi Bachelor i Muzikës	23	2	1	1	0	27
Profili Pedagogji e përgjithshme muzikore	21	2	1	1	0	25
Profili Kompozim	2	0	0	0	0	2
Programi Bachelor i Muzikës në Performim	43	7	0	0	0	50
Profili Solo këndim	4	0	0	0	0	4
Profili Dirigjim	1	0	0	0	0	1
Profili Piano	11	1	0	0	0	12
Profili Instrumente me harqe dhe tela	11	2	0	0	0	13
Moduli Violinë	3	0	0	0	0	3
Moduli Violë	2	1	0	0	0	3
Moduli Violonçelo	1	1	0	0	0	2
Moduli Kontrabas	2	0	0	0	0	2
Moduli Kitarë	3	0	0	0	0	3
Profili Instrumentet frymore	16	4	0	0	0	20
Moduli Flaut	5	1	0	0	0	6
Moduli Obo	1	0	0	0	0	1
Moduli Klarinetë	4	1	0	0	0	5
Moduli Trombon	2	0	0	0	0	2
Moduli Fagot	1	0	0	0	0	1
Moduli Korne	1	1	0	0	0	2
Moduli Trompete	1	1	0	0	0	2
Moduli Saksofon	1	0	0	0	0	1
Departamenti i Arteve Dramatike	50	6	1	3	0	60
Programi i Arteve Dramatike	50	6	1	3	0	60
Profili Aktrim	8	1	1	0	0	10
Profili Dramaturgjia dhe Skenar filmi	7	1	0	0	0	8
Profili Regji Filmi dhe Televizioni	5	0	0	1	0	6
Profili Regji Teatri	5	1	0	0	0	6
Profili Dizajn Skene dhe Kostumografi	9	1	0	0	0	10
Profili Kamerë dhe Montazhë	8	1	0	1	0	10
Profili Produksion	8	1	0	1	0	10

KUSHTET E REGJISTRIMIT

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

NË DEPARTAMENTET E ARTEVE VIZUALE:

Profili: Pikturë

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e vizatimit duke realizuar figurë sipas modelit të gjallë.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e pikturës.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portfolios.

Studentët, në ditën e provimit duhet të marrin me vete:

Për fazën e parë: Një pako letër apo hamer (letra, duhet të jetë së paku e formatit 50cm x 70cm), laps, laps thëngjilli dhe mjetet përcjellëse për vizatim.

Për fazën e dytë: Një kanavacë të formatit 50cm x 70cm, ngjyrat e vajit apo ngjyra akriliku dhe mjetet përcjellëse për pikturë.

Për fazën e tretë: Portfolio në versionin fizik dhe në versionin digjital

Portfolio në versionin fizik prezantohet gjatë intervistës dhe duhet të përmbajë 15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale të formatit A3 (5 vizatime, 5 piktura dhe 5 skica ideore) dhe një ese me gjatësi 400 fjalë, ku kandidatët duhet të adresojnë temën: “Cila është perspektiva juaj mbi rëndësinë e artit në shoqërinë bashkëkohore? Sipas jush, cili është kontributi kulturor dhe social i pikturës në shoqërinë tonë?”

Portfolio në versionin digjital duhet të dorëzohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu, menjëherë pas aplikimit.

Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t’u bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Skulpturë

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e vizatimit duke realizuar figurë sipas modelit të gjallë.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e skulpturës.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portfolios

Studentët, në ditën e provimit duhet të marrin me vete:

Për fazën e parë: Një pako letër apo hamer (letra, duhet të jetë së paku e formatit 50cm x 70cm)), laps, laps thëngjilli dhe mjetet përcjellëse për vizatim.

Për fazën e dytë: Studentët punojnë me materiale të siguruara nga Fakulteti.

Për fazën e tretë: Portfolio në versionin fizik dhe në versionin digjital.

Portfolio në versionin fizik prezantohet gjatë intervistës dhe duhet të përmbajë 15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale të formatit A3 (10 vizatime dhe 5 skica ideore).

Portfolio në versionin digjital duhet të dorëzohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu, menjëherë pas aplikimit.

Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t’u bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Grafikë

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e vizatimit duke realizuar figurë sipas modelit të gjallë.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e grafikës duke realizuar një detyrë kreative.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portfolios.

Studentët, në ditën e provimit duhet të marrin me vete:

Për fazën e parë: Një pako letër apo hamer (letra, duhet të jetë së paku e formatit 50cm x 70cm), laps thëngjilli dhe mjetet përcjellëse për vizatim.

Për fazën e dytë: Një hamer (letra duhet të jetë së paku e formatit 50cm x 70cm), tush dhe mjetet përcjellëse.

Për fazën e tretë: Portfolio në versionin fizik dhe në versionin digjital.

Portfolio në versionin fizik prezantohet gjatë intervistës dhe duhet të përmbajë 15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale të formatit A3 (5 vizatime, 5 grafika dhe 5 skica ideore).

Portfolio në versionin digjital duhet të dorëzohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu, menjëherë pas aplikimit.

Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'u bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Arti konceptual dhe mediat e reja

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e artit konceptual dhe mediave të reja, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët duhet të shkruajnë një ese prej 400 fjalësh, përmes së cilës vlerësohen njohuritë dhe perspektiva e tyre mbi artin.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portfolios.

Studentët, në ditën e provimit duhet të marrin me vete:

Për fazën e parë: Një pako letër të formatit 50x70cm, laps ose laps thëngjilli dhe ngjyrat sipas dëshirës.

Për fazën e dytë: Letër A4 dhe laps.

Për fazën e tretë: Portfolio në versionin fizik dhe në versionin digjital.

Portfolio në versionin fizik prezantohet gjatë intervistës dhe duhet të përmbajë 15 punime origjinale nga fusha e mediave të reja në të cilat mund të përfshijnë (fotografi, video, instalacione, intervenime artistike apo skica ideore).

Portfolio në versionin digjital duhet të dorëzohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu, menjëherë pas aplikimit.

Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'u bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Dizajn i inovacioneve

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e dizajnit dhe inovacioneve duke realizuar një detyrë kreative nga fusha e dizajnit të produkteve, dizajnit të modës, marketingut në rrjete sociale dhe fotografisë.
- Kandidatët duhet të shkruajnë një ese prej 400 fjalësh, përmes së cilës vlerësohen njohuritë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimit në softuerët e Adobe Suite përmes realizimit të një detyre kreative.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portfolios e cila duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versionin digjital në email adresën artevizuale@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e Dizajnit në të cilat mund të përfshijnë (dizajne të produkteve, dizajne të modës, animacione, fotografi, poster dhe punime të tjera kreative).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'u bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Dizajn i komunikimit

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e dizajnit duke realizuar një detyrë kreative në fushën e ilustrimit, mediave dixhitale dhe komunikimit vizual.
- Kandidatët duhet të shkruajnë një ese prej 400 fjalësh, përmes së cilës vlerësohen njohuritë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimin në softuerët e Adobe Suite përmes realizimit të një detyre kreative.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios e cila duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni digjital në email adresën artevizuale@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e Dizajnit në të cilat mund të përfshijnë (ilustrime, skica ideore, dizajn të web-faqes, video dhe punime të tjera kreative).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

Profili: Ilustrim dhe vizatim

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e vizatimit duke realizuar figurë sipas modelit të gjallë.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen provimit nga lënda e ilustrimit duke realizuar një detyrë kreative.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios.

Studentët, në ditën e provimit duhet të marrin me vete:

Për fazën e parë: Një pako letër apo hamer (letra së paku duhet të jetë e formatit 50cm x 70cm), laps, laps thëngjilli dhe mjetet përcjellëse për vizatim.

Për fazën e dytë: Një hamer (letra, duhet të jetë së paku e formatit 50cm x 70cm) dhe ngjyra sipas dëshirës.

Studentët janë të lirë të aplikojnë teknika të ndryshme dhe të përdorin materiale sipas zgjedhjes së tyre (kolazh, tush, ngjyra druri, akuarel, shënues me ngjyra, etj.)

Për fazën e tretë: Portfolio në versionin fizik dhe në versionin digjital.

Portfolio në versionin fizik prezantohet gjatë intervistës dhe duhet të përmbajë 15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale të formatit A3 (5 vizatime, 5 ilustrime dhe 5 skica ideore).

Portfolio në versionin digjital duhet të dorëzohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu, menjëherë pas aplikimit.

Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE MUZIKORE:

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në nivelin bachelor në Fakultetin e Arteve, respektivisht në profilet e Departamentit të Muzikës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

Duhet të ketë të përfunduar shkollën e mesme të Muzikës në instrumentin përkatës apo drejtimin përkatës.

BACHELOR I MUZIKËS NË PËRFORMIM

Profili: Piano

- Provim nga lënda PIANO - (a) J. S. Bach - 1 Prelud dhe Fugë nga WTC b) 1 Vepër virtuoze; c) 1 Sonatë klasike (një kohë); d) 1 Vepër madhore romantike;
- Provim nga lënda: SOLFEZH;
- Provim nga lënda TEORI E MUZIKËS;

Profili: Instrumentet me harqe dhe tela

- Provim nga instrumenti harkor përkatës - (a) J. S. Bach - 1 Kohë nga Suita / Partita; b) 1 Koncert (një kohë); c) 1 Sonatë (një kohë); d) 1 Pjesë cantilene;
- **Moduli: KITARË** - a) 2 kohë nga suitat e Bach-ut (nga suitat për çello ose flaut); b) F. SOR – 1 etydë nga op.6.dhe 29; c) 1 etydë përzgjedhje; d) 1 vepër ciklike:
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

Profili: Instrumentet frymore

- Provim nga lënda e instrumenti frymor përkatës- (a) 1 Koncert (komplet); b) 1 Sonatë (komplet); c) 1 Pjesë virtuoze;)
- Provimi nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

Profili: Solo këndim

- Provim nga lënda: SOLO KËNDIM -(a) 2 Arie (nga repertori operistik); b) 2 Këngë solo (në cilëndo gjuhë);
- Provim nga lëndët: SOLFEZH - TEORI e MUZIKËS
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

Profili: Dirigjim

- Dirigjim i një vepre për ansambël kamertal, orkestër apo për ndonjë formacion koral; (dirigjimi mund të realizohet me korepetitor ose me incizim në DVD). Incizimi duhet të fokusohet në fytyrë (profil) dhe në lëvizjet e duarve të kandidatit, si dhe mundësisht edhe të një pjese të orkestrës. Incizimi duhet të dorëzohet së paku dy ditë para provimit.
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lëndët: HARMONI
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

BACHELOR I MUZIKËS

Profili: Kompozim

- Prezantimi i **3 kompozimeve** të dorëzuara;
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lëndët: HARMONI - POLIFONI
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

Profili: Pedagogji e përgjithshme muzikore

- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: HARMONI
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE DRAMATIKE:

Programi i Arteve Dramatike

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

Profili: Aktrim

Pjesa e parë e programi eliminues:

- Recitim i një poezie (sipas zgjedhjes së kandidatit);

- Monolog dramaturgjia e autorëve- dramaturgëve botërorë dhe kombëtarë (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një këngë;
- Një imitim.

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues:

- Puna me mësimdhënës të caktuar,
- Verifikimi përfundimtar i aftësive.
- Të gjithë aplikantët lutën të sjellin fotografi “bust” në ditën e aplikimit.

Profili Regji Teatri

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqje, me skica për hapësirë skenike.

Provimi pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

Profili “Regji Filmi dhe Televizioni”

Provimi pranues është i ndarë në dy ditë dhe katër faza.

Dita e parë:

Faza e parë: Testi dhjetëpikësh

Të gjithë kandidatët, që konkurojnë në Regji Filmi dhe Televizioni, do t'i nënshtrohen testit me dhjetë pyetje rreth njohurive të përgjithshme për filmin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Faza e dytë: Shkrimi kreativ

Të gjithë kandidatët, të cilët i nënshtrohen fazës së parë, kalojnë në fazën e dytë, ku secili prej tyre do të trajtojë me shkrim temën e dhënë nga komisioni. Detyra ka kërkesa teknike dhe kreative. Ana teknike e saj është kufizimi, në më së shumti dy faqe, dhe kreative, përmbajtja e tekstit, të dëshmojë se kandidati-ja posedon potencial kreativ artistik, që mund të zhvillohet përgjatë studimeve.

Faza e tretë: Intervista

Të gjithë kandidatët, të cilët i nënshtrohen fazës së parë dhe të dytë, kalojnë në fazën e tretë.

Kjo fazë zhvillohet në formë të intervistës. Tani, komisioni ka lexuar dhe vlerësuar testin e parë, analizuar detyrën me shkrim dhe ka informacionin e nevojshëm për intervistim të secilit kandidat.

Komisioni komenton dy detyrat paraprake të kandidatës-it, shtron pyetje rreth kulturës, letërsisë, muzikës, dhe me theks të veçant kinematografisë.

Pas fazës së tretë, selektohen kandidatët me rezultatet më të mira nga fazat paraprake dhe kalojnë në fazën finale, e cila zhvillohet 24 orë më vonë.

Dita e dytë:

Faza e katërt: Filmi deri në tre minuta, pa montazh

Në këtë fazë kalojnë vetëm kandidatët, të cilët komisioni i konsideron si më të mirët në fazat paraprake. Të gjithë kandidatët, që kalojnë në këtë fazë, kanë detyrë që të xhirojnë një film në temën të cilën e kanë punuar me shkrim në fazën e dytë. Detyra është e thjeshtë. Kandidati-ja mund ta xhirojë filmin e tij/saj deri në tre minuta, pa e montuar fare. Ai/ajo bënë xhirimin e filmit në formë kronologjike, bazuar në rrefimin që ka shkruar në fazën e dytë.

Paisja për xhirim të filmit sigurohet nga vetë aplikanti. Paisja mund të jetë nga kamerat profesionale, deri në telefon të thjeshtë celular.

Profili dramaturgjii dhe skenar filmi:

Zvillimi i një skene dramatike përmes dialogut, me shkrim sipas një rrethane të caktuar.

Përmbledhje (sinopsis) i një ngjarje të mundshme për një skenar filmi.

Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga fusha e dramaturgjisë , kinematografisë dhe njohuri të përgjithshme.

Profili Dizajn skene dhe Kostumografi

Faza e parë:

Kandidatët i nënshtrohen testimi nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit të gjallë, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë:

Kandidatët i nënshtrohen testimi nga njohuritë e dizajnit të skenes dhe kostumeve duke realizuar një detyrë kreative (tematike).

Faza e tretë:

Intervista dhe prezantimi i portfolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik dhe digjital) me se paku 10-15 punime origjinale nga fusha e dizajnit të skenës dhe kostumeve në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, ilustrime, dizajne të skenës, dizajne të kostumeve dhe skica ideore).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkingjiten edhe skicat fillestare.

Studentët, në ditën e provimit duhet të marrin me vete:

Një pako letër për vizatim (letra, duhet të jetë së paku e formatit 50cm x 70cm), laps, laps thëngjilli, ngjyra akrilik dhe mjetet përcjellëse për vizatim dhe pikturë, si dhe një bllok letër apo hamer për fazën e dytë.

Portfolio në versionin digjital duhet të dorëzohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu, menjëherë pas aplikimit.

Profili Produksion

Faza e parë

Kandidatët që konkurrojnë në profilin Produksion duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti, filmi, televizioni, radio dhe teatri.

Faza e dytë

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, do të nënshtrohen provimit, duke shkruar një koncept- ide të një projekti teatror, filmik, televiziv, apo artistik.

Faza e tretë

Kandidatët do të prezantojnë, mbrojnë projektin e tyre në fazën finale, në provim gojor, para komisionit.

Profili: Kamerë dhe Montazhë

Kontrolli i plotësimit të kriterëve për programin e studimit për kandidatët “Kamere dhe Montazh filmi” përbëhet nga dy pjesë:

1. Në pjesën e parë, të gjithë kandidatët i nënshtrohen:
 - Bërja e një testi të kulturës së përgjithshme.
 - Një provim me shkrim - analizë (maksimum një faqe) e një filmi të shkurtër I cili prezantohet nga komisioni vlerësues para kandidatëve rreth kadrimit dhe montazhit.
 - Një provim gojor - një shtjellim i analizës me shkrim, si dhe pyetje nga fusha e Filmit, TV.

2. Pas pjesës së parë, bazuar në rezultatet, Komisioni vendos drejt përzgjedhjes së kandidatëve në një listë të shkurtër, dhe kandidatët e përzgjedhur hyjnë në pjesën e dytë të procesit të përzgjedhjes:
- Detyra praktike nga fusha e Kamerës dhe Montazhit të Filmit dhe TV, të prezantohet motivi me shkrim para komisionit, ide apo sinopsis në formë të shkruar jo më gjatë se një faqe.
 - Pastaj kandidati duhet ta realizojë filmin jo më të gjatë se 3min, pra xhirohet dhe montohet, detyra pastaj vlerësohet nga komisioni vlerësues.
 - Një provim gojor ku kandidati do ta mbrojë punimin e tij para komisionit vlerësues, nga profili Kamerë dhe Montazh.

Bazuar në rezultatet nga pjesa e parë dhe e dytë të kontrollit, Komisioni rendit dhe zgjedh kandidatët që kanë të drejtën të regjistrohen në profilin Kamere dhe Montazh.

Literatura për provim pranues: Aktrim, Regji Teatri, Regji Filmi, Dramaturgjia, Dizajni skenë dhe Kostumografia, Produksion, Kamerë dhe Montazhë

- Georg Sodull: “Historia e filmit”
- Abaz Hoxha: “Historia e filmit shqiptar”
- Luis Herman: Skenari i filmit dhe i televizionit
- Jezhi Plazhevski: Gjuha e filmit
- Fadil Hysaj: “Teatrologji, dramaturgjia, regji dhe aktrim”
- Aristoteli: “Poetika”
- Vlladan Shvacov: “Bazat e dramaturgjisë”
- Dr. Nebi Islami: “Historia e dramës kombëtare 1886-1996”
- Dr. Josif Papagjoni: “Komedi që vjen nga skena”
- Eskili: “Orestia”
- Sofokli: Një tragjedi
- Aristofani: Një komedi
- Shekspiri: Një tragjedi
- Molieri: Një komedi
- Dramaturgjia nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.
- Dramaturgjia bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasem Terbeshina etj.
- U. Gregor and E. Patalas: “History of Film”
- K. Raisz and G. Millar: “Film Editing”
- Marcel Martin: “The Language of Film”
- Jerzy Plazewski: “Jezik filma”
- Andre Bazin: “What is Cinema” (I, II, III, IV)

XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **250** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studim e të rregullta	Kandidatë nga komunitet et jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvegja, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Gjithsëj
Bujqësisë dhe Veterinarisë	205	30	6	6	3	250
Programi Prodhim bimor	65	10	2	2	1	80

Programi Mjekësi Veterinare	16	2	1	1	0	20
Programi Ekonomia e Bujqësisë	41	6	1	1	1	50
Programi Teknologji ushqimore me bioteknologji	59	8	1	1	1	70
Programi Prodhim Shtazor	24	4	1	1	0	30

PROVIMI PRANUES

Në programin Mjekësi Veterinare, provimi pranues mbahet në lëndët: Kimi dhe Biologji, ndërsa për programet tjera, provimi mbahet në lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë.

